

LIGJ
Nr. 30/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8905, DATË 6.6.2002 “PËR MBROJTJEN
MJEDISIT DETAR NGA NDOTJA DHE DËMTIMI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8905, datë 6.6.2002 “Për mbrojtjen mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi “Inspektorati i Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”.

Neni 2

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Emërtimi “Inspektorati i Peshkimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Inspektimi, në zbatim të këtij ligji, bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 3

Në nenin 19, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organi që vendos gjobën, bën shqyrtimin e saj dhe merr vendimin përfundimtar, sipas këtij neni, është inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit.”

Neni 4

Pas nenit 19 shtohen nenet 19/1 dhe 19/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 19/1

Klasifikimi i dënimeve dhe masat urgjente

1. Dënimet administrative të dhëna në zbatim të këtij ligji klasifikohen si më poshtë:

a) Gjoha është dënim kryesor.

b) Masa e pezullimit të përkohshëm ose e ndërprerjes së veprimtarisë, ndalimi i menjëhershëm i veprimtarisë dhe sekuestrimi i mjeteve dhe pajisjeve janë dënime plotësuese.

2. Nëse është e nevojshme, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, merr masa urgjente sipas ligjit për inspektimin.

Neni 19/2

Ankimi dhe ekzekutimi

1. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit për marrjen e masave urgjente, dënimin me gjobë dhe vendosjen e dënimeve plotësuese bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.
2. Ekzekutimi i vendimeve të inspektoratit bëhet në përputhje me dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7989, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani